



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E  
FËMIJËVE DHE TË RINJVE

Nr. 5750 Prot.  
Shkodër, më 8 / 4 / 2019

Nr. 252 Prot.  
Shkodër, më 08 / 04 / 2019

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
BASHKISË SHKODËR  
DHE  
OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE TË RINJVE**

*E lidhur sot me datën 08.04.2019, mes palëve:*

1. **Bashkia Shkodër**, me adresë: Rruga 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, Shqipëri, përfaqësuar nga *Kryetarja, Znj. Voltana Ademi*, në vijim e cilësuar si **"Bashkia"**

*dhe*

2. **Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, Tiranë**, me adresë: Rr. "Bvl. Bajram Curri", Nd.136, H.14, Ap.1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, e regjistruar me vendim gjykatë nr. 813/5 datë 21.12.2017, përfaqësuar nga *Znj. Elma Tershana*, në vijim cilësuar si **Observatori**.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**Objekti**

Objekt i kësaj marrëveshje mes Bashkisë, dhe Observatorit është bashkëpunimi për realizimin e projektit "Çdo fëmijë në shkollë", që ka në fokus të tij punën për identifikimin e fëmijëve në moshë për arsimin e detyrueshëm që janë jashtë shkolle në Shqipëri.

**Neni 2**

**Qëllimi**

Qëllimi i marrëveshjes është të përcaktojë mënyrat e bashkëpunimit mes palëve, që synon lehtësimin e regjistrimit dhe integritet të 2 fëmijëve në klasën e pare përmes vënies në dispozicion të një granti, që do të përfshijë ndihmë ndaj fëmijëve sipas nevojave që janë identifikuar nga vlerësimi i secilit prej këtyre rasteve.

**Neni 3**

**Projekti**

Ndërsa shumica dërrmuese e fëmijëve në moshë për të ndjekur arsimin e detyrueshëm në Shqipëri shkojnë në shkollë, disa mbeten të përjashtuar nga arsimi për shkak të faktorëve të ndërlikuar dhe të mbivendosur, si migracioni, varfëria e skajshme, aftësi të kufizuar, mentaliteti prindëror ose praktikrat kulturore, çështjet gjuhësore apo rrethanat e vështira familjare.

- a) Një punonjës i Bashkisë shërben si pikë kontakti për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Pikës së Kontaktit i jepet mbështetja e duhur për të realizuar detyrat sipas kësaj marrëveshjeje.
- b) Bashkia është përgjegjës për përdorimin e grantit në plotësim të nevojave të secilit prej 2 rasteve të fëmijëve të përcaktuara nga vlerësimi i nevojave të tyre nga ekspertët e fushës, si Njësia për Mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës. Bashkia duhet të sigurojë që angazhimi të kryhet sipas standardeve dhe marrëveshjes brenda periudhës së rënë dakord.
- c) Bashkia do të jetë përgjegjës për raportet financiare dhe narrative. Raportet do të dorëzohen tek Observatori në dy kopje (2) origjinale dhe me postë elektronike (email) në gjuhën shqipe. Kontraktuesi do të raportojë narrativisht dhe financiarisht sipas kërkesës së Observatorit.
- d) Raporti përfundimtar do të realizohet dhe dergohet tek Observatori në muajin qershor 2020. Bashkia nuk lejohet të bëjë ndonjë ndryshim në këtë kontratë ose të bëjë ndonjë shtojcë të kontratës. Bashkia nuk ka të drejtë për ndonjë përfitim shtesë, pagesë, subvencion, kompensim ose të drejta, përveç kur përmendet në këtë kontratë.
- e) Bashkia duhet të sigurojë vizibilitetin e kontributit të UNICEF-it për partneritetin dhe mbështetjen financiare si dhe Observatorit për të gjitha materialet e prodhuara apo shpërndara në këtë grant.

***Detyrimet e të drejtat e organizatës “Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve”***

- a) Observatori duhet të vërë në dispozicion të Bashkisë një fond të parashikuar për mbështetjen e 2 fëmijëve që do të përfitojnë përgjatë gjithë vitit shkollor 2019 - 2020 në përputhje me shërbimet të parashikuara në Planin e ndërhyrjes së miratuar sipas buxhetit dhe afateve të parashikuara në nenin 8 pika e.
- b) Observatori në kuadër të nismës “Çdo fëmijë në shkollë”, mbështetur nga UNICEF, zotëron të gjitha të drejtat e pronësisë, përfshirë të drejtat e autorit, për çdo material të shkruar; të botuar të prodhuar sipas kësaj marreveshjeje. Megjithatë, materialet duhet të përdoren vetëm duke cituar referencën e botimit.

**Neni 8**  
**Buxheti**

a) **Tarifat dhe kostot e rimbursueshme**

Kontraktuesi ka të drejtën e tarifave dhe kostove të rimbursueshme në përputhje me buxhetin e miratuar të grantit.

b) **Buxheti**

Shuma totale e grantit që i jepet Bashkisë së Shkodrës për 2 rastet e fëmijëve që duhet të integrohen në shkollë është 88,000 Lek bruto. Shuma që do i jepet çdo fëmijë është 44,000 Lek.

c) **Fatura dhe pagesa**

Observatori nënshkruan këtë marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Shkodër për ekzekutimin e totalit të vlerës prej 88,000 Lek bruto.

d) **Detajet lidhur me pagesën:**

Pagesa sipas kësaj marreveshjeje do të bëhet në Degën e Thesarit Shkodër, për llogari të Bashkisë Shkodër pasi kjo e fundit të këtë lëshuar faturën për arkëtim.

NIPTI i Bashkisë Shkodër është: K3681300H.

e) **Afati**

Granti do të jetë periodik dhe do të mbulojë nevojat e 2 fëmijëve përgjatë vitit shkollor 2019 - 2020. Afati i përdorimit të këtij granti përfundon në qershor 2020. Bashkia e



- b. Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët duhet të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive të marrëveshjes në interes të përfituesve.
- c. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët, hartohet në gjashtë kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.
- d. Kjo marrëveshje mund të bëhet publike me firmosjen e saj.

**Për Bashkinë Shkodër**

**Znj. Voftana ADEMI  
Kryetare**



**Për Organizatën "Observatori për të  
drejtat e fëmijëve dhe të rinjve"**

**Znj. Elma TERSHANA  
Drejtoreshë Ekzekutive**

